2023



BASHKIA PATOS

# PROJEKT-VENDIMI I BUXHETIT TË VITIT 2023 DHE PRPJEKT-BUXHETIT AFATMESEM 2023-2025

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**BASHKIA PATOS**

**Nr._____Prot.** **Patos më, ____/____/2022**

**MIRATOHET**
**NËPUNËSI AUTORIZUES**
**KRYETARE**
Rajmonda **BALILAJ**

**PROJEKT-VENDIM**
**Nr.______, datë___.___.2022**

**PËR MIRATIMIN E NUMRIT TË PËRGJITHSHËM TË PUNONJËSVE,BUXHETIN PËR VITIN 2023, DHE DOKUMENTIN PËRFUNDIMTAR TË PROJEKT BUXHETIT AFM 2023-2025**

Bazuar në shkronjën "dh" neni 54 të ligjit 139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore",nenin 6,11,44 pika b te ligjit nr.9936 datë 26.06.2008 "Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë",ligjin nr.10296 "Për Menaxhmin Financiar dhe Kontrollin", në kreun III neni 10-21, kreun VII neni 33,34,40 të ligjit 68/2017 "Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore", në nenin 65 pika 1 të ligjit "Për Mbrojtjen Civile", Vendimin e KB nr 4. datë 16.03.2022 "Për miratimin e raportit të vleresimeve dhe parashikimit afatmesëm të të ardhurave 2023-2023", Vendimin e Këshillit Bashkiak nr.49 datë 20.07.2022 mbi miratimin e "Tavanëve Përfundimtarë të Programit Buxhetor Afatmesëm 2023-2025",VKB nr.82 dt.25.11.2022 "Mbi nivelin e taksave dhe tarifave vendore për vitin 2023", GMS paraqet për miratim Projekt-Vendimin dhe,

PROPOZON :

1.Të miratojë numrin e përgjithshëm të punonjësve të Bashkisë, sipas programeve buxhetore dhe njësive shpenzuese për vitin 2023, i cili është **369** punonjës sipas tabeles nr.7.
2.Të miratojë Buxhetin e Bashkisë Patos për vitin 2023, si më poshtë vijon:

a.Plani i të ardhurave të Bashkisë Patos për vitin 2023 është në shumën **543,737,000** lekë detajuar sipas burimeve si më poshtë:

| Plani i të ardhurave | Në lekë |
|---|---|
| **Të ardhura nga taksat dhe tarifat vendore** | **287,999,000** |
| ❖ Të ardhura tatimore | 184,282,000 |
| ❖ Të ardhura jo tatimore | 98,117,000 |
| ❖ Ardhuratëtjera(gjobat+kuota) | 5,600,000 |
| **Të ardhura nga transferta e pakushtëzuar** | **154,219,000** |
| **Të ardhura nga transferta specifike** | **101,519,000** |
| **TOTALI** | **543,737,000** |

b.Plani i shpenzimeve të Bashkisë Patos për vitin 2023, është në shumën **543,737,000** lekë, detajuar si më poshtë:

| Plani i shpenzimeve | Në lekë |
|---|---|
| Shpenzime korrente | 388,139,195 |
| Shpenzime kapitale | 146,597,805 |
| Fondi Rezerve/Kontigjenc/Mbrojtje civile | 9,000,000 |
| **TOTALI** | **543,737,000** |

3.Të Ardhurat dhe Shpenzimet e Buxhetit, sipas zërave kryesorë, në nivel programi për dy vitet e përparshme fiskaledhe tri vitet e ardhshme sipas tabelave nr.1/1 dhe 1/2 , dhe tabelës nr.6 .

a) Të miratojë detajimin e shpenzimeve të buxhetit për vitin 2023, objektet e investimeve prioritare, sipas pasqyrave financiare nr.1, nr, 2, nr 3, nr.4, nr. 4.1, nr.5, si pjesë përbërëse e projekt-buxhetit.
b) Të miratojë shpërblimin e këshilltarëve në masën 10% të pagës së kryetares, 9% të pagës së kryetares së Bashkisë kryetari i fshatit Dukas, 7% të pagës së kryetares, kryetaret e tjerë të fshatrave të Bashkisë dhe 10% të pagës së administratorëve për kryetarët të fshatrave të tjerë.

c) Të miratojë fondin prej 4,325,326 lekë për shpronësimin e objekteve të reja që preken nga rikonstruksioni dhe nderhyrja me investime.
d) Të miratojë fondin prej 1 400 000 lekë bashkefinancim për programin 'ReLOaD'',sipas memorandumit të miratuar me VKB nr.49 datë 15.10.2021.
e) Të miratojë rritjen e limitit të të ardhurave të Bashkisë Patos për vitin 2023 për diferencat e papërdorura në të ardhura e shpenzime të vitit 2022 sipas shumës së përcaktuar në akt-rakordimin përfundimtar në degën e Thesarit Fier. Ky fond të përdoret për likuidimin e shpenzimeve korrente dhe kapitale të miratuara me buxhetin e vitit 2022 të pafinancuara brenda këtij viti , dhe pjesa e mbetur për objekte të reja për investim sipas planit të investimeve kapitale dhe prioritete të miratuar në Këshillin Bashkiak ,duke përdorur dhe çdo burim tjetër të ofruar nga donatorë.
f) Të ngarkohet Nëpunësi Autorizues i Bashkisë të kryejë rishpërndarjet si më poshtë:
    - Ndërmjet projekteve të investimeve, brenda të njëjtit program,
    - Ndërmjet zërave të shpenzimeve korrente, brenda të njëjtit program,
    - Rishpërndarjet brenda të njëjtit program dhe zërit të shpenzimeve korrente, ndërmjet njësive të ndryshme shpenzuese të cilat miratohen nga nëpunësi autorizues i njësisë së qeverisjes vendore nga e cila varet njësia shpenzuese.

4.Të ngarkohet Zyra e Financës të kryejë avancim të fondeve mujore sipas realizimit të të ardhurave për vitin 2023.

**GRUPI I MENAXHIMIT**

Astrit MURATI Mimoza **SHTËMBARI** Armando **GUSHI** Vangjel **NUSHI** Ledio **ÇAPO**

Shkëlqim **BEQIRAJ** Arben **SHPËRDHEJA** Anisa **PETANI** Lindita **QALLIAJ** Agim **MUSKAJ**

Artiol **HOXHA** Haredin **MUCO** Luto **YZEIRAJ** Orges **GOLLOSHI** **Alket HALIMI**

Blerina **LAÇI** Alba **GOLLOSHI** Nurkë **HAZIZAJ** Elda **GOXHAJ** Mitjon **NIKOLLA**

Juela **SHPATA** Valbona **SEMANJAKU**

Adm. Njësia Administrative Zharrëz Adm. Njësia Administrative Ruzhdije

Polikseni **TUPA** Agim **MESUTAJ**

*Shënim: Gjatë fazës së buxhetimit ka marr pjesë dhe përgjegjësi i sektorit të Auditit të Brendshëm Hajdar MEÇE.*